

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PESHKOPI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Peshkopi me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 100, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 414/7, datë 30.6.2012, dërguar z. **Ilir KROSI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Të merren masa për organizimin e një trajnimi për njohjen dhe implementimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” manualin e Ministrisë Financave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me urdhrin nr. 8980, datë 15.07.2010, të cilat kanë hyrë në fuqi më 01.01.2011, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Menjëherë**

2. Të merren masa për krijimin e Zyrës së Aseteve e cila të kryej inventarizimin, vlerësimin, marrjen në dorëzim të pronave dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” sipas pikave 9,10,11,13,14.

**Menjëherë**

3. Sektori i Financës dhe i shërbimeve, të rishikojë normativat e harxhimit të karburantit për çdo automjet të Bashkisë dhe ti miratojë në Këshillin Bashkiak. Të mbahen fletë udhëtime për çdo automjet si dhe grafik pune periodik për makinat e pastrimit.

**Menjëherë**

4. Të merren masa për reduktimin e numrit të mjeteve që disponon, në zbatim të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësve civile” dhe VKM nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit” pasi disa mjete nuk janë të nevojshme dhe kanë rritur koston e shpenzimeve të transportit.

**Menjëherë**

5. Të merren masa për përmirësimin e punës në Sektorin e Financës duke angazhuar specialistë me përvojë pune dhe arsim përkatës si dhe për shkurtimin e organikës në disa sektorë të tjerë pasi nuk justifikohet ngarkesa e punës për disa vende pune.

**Menjëherë**

6. Sektori i Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve dhe faturave të prapambetura nga buxheti i vitit 2012 në mënyrë që të mos bëjë mbartje për vitin e ardhshëm, në zbatim të pikës 1.2 të Udhëzimit të MF nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

**Menjëherë**

7. Të bëhet hyrje në magazinë plani i rilevimit të banesave sociale për vlerën 63,700 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 19, datë 02.02.2011 në përputhje me kërkesat e nenit 13/c të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Menjëherë**

8. Të rishikohet kontrata e bukës pasi çmimi i saj rezulton 16 lekë mbi çmimin e tregut dhe pesha e saj rezulton 0.2 kg më pak se standardet e miratuara në kundërshtim me nenin 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet Publike” i ndryshuar, me kontratën datë 5.5.2011 dhe shtesën e kontratës datë 16.01.2012, neni 7, si dhe me nenin 13/ç të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

**Menjëherë**

9. Sektori i Financës të mbajë dhe azhurnojë ditarin e pagave, ditarin e veprimeve të ndryshme dhe centralizatorin, për të evituar kalimet e veprimeve ekstra kontabël në bilanc.

**Menjëherë**

10. Të merren masa nga Zyra e Urbanistikës në bashkëpunim me INU dhe Policinë Bashkiake për kontrollin dhe evidentimin në terren të gjendjes së objekteve për të cilat është miratuar leja e ndërtimit por nuk është zbardhur, të merren masa bllokimi dhe në bazë të ligjit të detyrohen subjektet të përmbushin detyrimet kundrejt Bashkisë për të cilat është mbajtur pezull zbardhja e lejes së ndërtimit.

**Menjëherë**

11. Të ngrihet një grup pune për verifikimin e dosjeve të lejeve të shesheve dhe të ndërtimit për plotësimin e tyre me dokumentacionin e kërkuar, përcaktimin e kondicioneve urbanistike, studimin e gjendjes ekzistuese për orientimin e grupit të punës në procesin e hartimit të planit të përgjithshëm rregullues si dhe të arkivohen dosjet sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

**Menjëherë**

12. Të merren masa për regjistrimin e lejeve të ndërtimit pas zbardhjes për ndjekjen e tyre deri në dhënien e lejes së shfrytëzimit, të evidentohet qartë dhe saktë detyrimi për financimin e studimeve urbanistike dhe të ndikimit në infrastrukturë, të kontabilizohen më vete dhe të respektohet destinacioni i përdorimit të tyre sipas ligjit.

**Vazhdimisht**

13. Të merren masa për administrimin e dosjeve teknike të ndërtimit të objekteve dhe arkivimin e tyre pas kontrollit rigoroz të plotësimit të detyrimeve nga subjektet në lidhje me plotësimin sipas projekteve të zbatimit të volumeve të punëve në sasi dhe cilësi.

**Menjëherë**

14. Të aplikohet dhe arkëtohet kamatë për ditë vonesë në pagesën e detyrimeve për leje ndërtimi në shumën 1,462,890 lekë për 33 subjekte.

**Menjëherë**

15. Për çdo prokurim të respektohen procedurat e përcaktuara në ligj për të mos shkaktuar konfuzion tek pjesëmarrësit në konkurrim sidomos në përcaktimin e fondit limit duke bërë analizë profesionale të kostos së mallrave dhe shërbimeve të lidhur ngushtë me objektin që prokurohet dhe të evidentohet nga ana e njësisë së prokurimit gjithë procedura e prokurimit si dhe të arkivohen dosjet e prokurimit.

**Vazhdimisht**

16. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet e qirave si dhe subjektet debitorë në shumën 7,285,500 lekë trajtuar hollësisht në faqet 40 dhe 54.

**Menjëherë**

17. Të merren masa për përfshirjen në planifikimin e të ardhurave të shumës 7,731,500 lekë (taksat e pastrimit, të ndriçimit dhe të pasurive të paluajtshme) në bazë të numrit të familjeve nën juridiksionin e Bashkisë.

**Menjëherë**

18. Të kontabilizohen gjobat në masën 25 % të detyrimit të pa paguar në afatet ligjore për 52 subjekte në vitin 2010 në shumën 504,375 lekë dhe 42 subjekte në vitin 2011, në shumën 154,500 lekë.

**Menjëherë**

19. Të merren masa për fillimin e ecurisë për regjistrimin në ZVRPP të rrethit të 1445 pronave që i kanë kaluar Bashkisë me VKM nr. 1533, datë 19.11.2008.

**B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT**

Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit të shkaktuar buxhetit të Bashkisë në vlerën **10,874,250 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga e cila 1,859,812 lekë në fushën e administrimit material e monetar, 7,133,759 lekë në fushën e urbanistikës dhe 1,880,667 lekë në fushën e taksave dhe tarifave vendore si më poshtë :

1. Vlera **32,400 lekë**, për pagesa të kundërligjshme për 7 anëtarë të KRRT-së jo të pranishëm në disa mbledhje për vitin 2010, përkatësisht: ■ 2,700 lekë, ■ 5,400 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 8,100 lekë, ■ 5,400 lekë, ■ 5,400 lekë, dhe ■ 2,700 lekë, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” ndryshuar.

Menjëherë

2. Vlera **494,202 lekë**, për orë jashtë orarit të punës dhe për pagesa për ditë festash, sipas listë pagesave të muajit dhjetor me urdhrin nr. 36, datë 31.12.2011 si dhe listë pagesave të muajit tetor me urdhrin nr. 27, datë 31.10.2011, veprim në kundërshtim me pikën 1/2, 3 dhe 3/a e b të udhëzimit MF nr. 16, datë 20.07.2011, me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”, përkatësisht: 63 veta të aparatit Bashkisë për 131,266 lekë, 70 veta të pastrim gjelbërimit për 96,518 lekë, 6 veta për 11,723 leke, 2 veta gjendjes civile për 7,014 lekë, 2 punonjës të Q.K.R. për 4,182 lekë, 64 veta të çerdheve dhe konviktit për 103,160 lekë, 9 veta aparatit Bashkisë për 92,009 lekë dhe 2 veta të kopsht-çerdheve për 48,330 lekë.

Menjëherë

3. Vlera **513,988 lekë**, pagesa të lejeve të zakonshme të vitit 2010 në vitin 2011 sipas urdhrin të titullarit nr. 13, datë 4.4.2011; nr. 14, datë 21.4.2011 dhe nr. 16, datë 20.5.2011, veprim në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 1/d “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”, konkretisht: ■ 30,000 lekë, ■ 25,840 lekë, ■ 25,840 lekë, ■ 25,840 lekë, ■ 25,840 lekë, ■ 21,520 lekë, ■ 21,520 lekë, ■ 31,500 lekë, ■ 23,680 lekë, ■ 38,700 lekë, ■ 28,000 lekë, ■ 28,000 lekë, ■ 22,168 lekë, ■ 44,550 lekë, ■ 39,150 lekë, ■ 28,000 lekë dhe ■ 28,000 lekë.

Menjëherë

4. Vlera **240,684 lekë**, për shpërblime të ndryshme, përkatësisht:

-vlera 93.000 lekë shpërblyer 93 gra të Bashkisë Peshkopi nga 1,000 lekë secila për festën e 8 marsit 2010 sipas urdhrin të titullarit nr. 15 datë 8.3.2010 dhe listë pagesave të muajit mars 2010, veprim në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin e fondit të veçantë”.

-vlera 128,360 lekë, shpërblim 1 pagë mujore për punë të mirë, sipas listë pagesave të muajit tetor 2010 dhe urdhrin nr. 48, datë 01.11.2010, përkatësisht: ■ 30,000 lekë, ■ 20,360 lekë, ■ 22,800 lekë, ■ 27,600 lekë dhe ■ 27,600 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2010” dhe pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin e fondit veçantë”,

-vlera 19,324 lekë për ■ e cila ka përfituar shpërblim për 1 pagë mujore për punë të mirë, sipas urdhër shpenzimit nr. 176, datë 22.6.2011 dhe urdhrin nr. 18, datë 20.06.2011, veprim në kundërshtim me pikën 1/c të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” dhe me pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin e Fondit të Veçantë”.

Menjëherë

5. Vlera **320,000 lekë**, për diferencë të çmimit bukës, përkatësisht njësia e prokurimit ■ 45,715 lekë, ■ 45,715 lekë, ■ 45,715 lekë dhe ■ (kryetar i KVO) 45,715 lekë, ■ 45,715 lekë, ■

(anëtar) 45,715 lekë dhe z. ■ 45,715 lekë, kryetar i autoritetit kontraktor. Veprime këto në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me kontratën datë 5.5.2011 dhe kontratën shtesë datë 16.01.2012, neni 7 “Kushtet e lëvrimit” specifikimet teknike si dhe me nenin 13/ç të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

#### Menjëherë

**6. Vlera 143,300 lekë**, përfituar dieta tepër në kundërshtim me VKM nr. 228, datë 13.4.2001, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika III/3 nënpika 3.2 dhe pika III/3 nënpika 3.3 si dhe me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 “Për tarifat e transportit udhëtarëve”, përkatësisht: ■ 10,000 lekë, ■ 10,000 lekë, ■ 4,000 lekë, ■ 19,000 lekë, ■ 4,400 lekë, ■ 4,400 lekë, ■ 5,500 lekë, ■ 3,000 lekë, ■ 9,000 lekë, ■ 15,000 lekë, ■ 3,000 lekë, ■ 3,000 lekë, ■ 21,240 lekë, ■ 2,200 lekë, ■ 6,000 lekë, ■ 4,000 lekë, ■ 8,160 lekë, ■ 3,000 lekë dhe ■ 8,400 lekë .

#### Menjëherë

**7. Vlera 72,500 lekë** për klub shumë sportin Peshkopi, përkatësisht:

-vlera 13,500 lekë për shpërblimin me rastin e 8 marsit 2011,për: ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë dhe ■ 2,700 lekë, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin e fondit të veçantë” dhe VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 1/b dhe c, d.

-vlera 59,000 lekë për dieta, sipas mandatpagesës nr. 31, datë 24.10.2011, nr. 1, datë 13.01.2011, nr. 7, datë 24.3.2011 dhe nr. 32, datë 01.11.2011, marrë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika III/3 nënpika 3.2, përkatësisht: ■ 2,000 lekë, ■ 4,000 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 4,000 lekë, ■ 2500 lekë, ■ 4,000 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,500 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 2,000 lekë, ■ 500 lekë, ■ 500 lekë, ■ 500 lekë, ■ 500 lekë dhe ■ 500 lekë.

#### Menjëherë

**8. Vlera 42,750 lekë** për Qendrën Kulturore Peshkopi, përkatësisht:

-vlera 27,000 lekë, shpërblim për aktivitete social kulturore, për ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë, ■ 2,700 lekë dhe ■ 2,700 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimin e fondit të veçantë” dhe VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 1/b dhe c, d.

-vlera 15,750 lekë për dieta të pa justifikuar për ■ 6,000 lekë dhe ■ 9,750 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika III/3 nënpika 3.2.

#### Menjëherë

**9. Vlera 7,133,759 lekë** në fushën e urbanistikës, mosarkëtim i detyrimeve për financimin e studimeve urbanistike dhe të ndikimit në infrastrukturë, nga:

- 7 subjekte në vlerën 126,619 lekë të cilat kanë marrë lejen e shfrytëzimit dhe kanë regjistruar objektet në ZVRPP.

- 21 subjekte në vlerën 5,495,452 lekë për të cilat nuk është zbardhur leja e ndërtimit por që ndërtimet kanë përfunduar ose janë në proces.

- 22 subjekte në vlerën 1,511,688 lekë për të cilat është zbardhur leja e ndërtimit.

#### Menjëherë

**10. Vlera 1,880,667 lekë** nga 44 subjekte të biznesit të palicencuar për vitin 2010 dhe 49 subjekte të biznesit të palicencuar për vitin 2011.

#### Menjëherë

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

a. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, ligjit 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a i rekomandojmë Agjencisë Prokurimeve Publike që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike” të gjobisë në masën 50,000 lekë personat si më poshtë:

**1. Z. [REDAKTUAR]** me detyrë jurist dhe me cilësinë e Përgjegjësit të Njesisë Prokurimit për vitin 2010, **gjobë në masën 50,000 lekë.**

**2. Zj. [REDAKTUAR]** me detyrë Specialiste e Buxhetit dhe me cilësinë e Anëtares së Njesisë Prokurimit për vitin 2010, **gjobë në masën 50,000 lekë.**

**3. Z. [REDAKTUAR]** me detyrë Inspektor për Shërbimet dhe Mjedisin dhe me cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit për vitin 2010, **gjobë në masën 50,000 lekë** pasi:

Njësia e Prokurimit për vitin 2010:

-Nuk ka mbajtur procesverbal të procedurës së prokurimit dhe hartimit të dokumenteve standard të tenderit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu V, pika 2, germa a.

-Nuk ka miratuar DST dhe specifikimet teknike tek Titullari i Autoritetit Kontraktor.

-DST nuk janë nënshkruar nga anëtarët e njesisë prokurimit, janë formale, të shkarkuara tip nga sistemi, me shumë rubrika të paplotësuara duke mos përcjellë informacionin e duhur për pjesëmarrësit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu III, pika 1, germa a dhe Kreu V, pika 2, germa a.

Këto shkelje janë vërejtur në të gjithë tenderët e zhvilluar në vitin 2010.

-Në dosjen e tenderit nuk administrohet projekti mbi bazën e të cilit llogaritet preventivi i përllogaritjes së fondit limit. Ndodhet një preventiv oferte i pa nënshkruar dhe i pa miratuar me 45 zëra punimesh dhe me volumet përkatëse pa çmimet dhe vlerat mbi bazën e të cilave duhej të përcaktohej fondi limit. Nuk ka analizë çmimesh ku duhej të bazohej fondi limit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu V, pika 1, germa c.

-Në dosje nuk administrohet kontrata e lidhur por vetëm formulari i kontratës. Nga verifikimi i likuidimit të situacioneve bashkangjitur urdhër shpenzimeve është vetëm formulari i kontratës dhe jo referencat e kontratës specifike.

Këto shkelje janë vërejtur në tenderin “Sistemimet e jashtme dhe infrastruktura e objektit në vazhdim Banesa Sociale” me fond limit 3,900,000 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 23.7.2010;

**4. Z. [REDAKTUAR]** me detyrë Inspektor për Planifikimin e Zhvillimit të Territorit dhe me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2010, **gjobë në masën 50,000 lekë.**

**5. Z. [REDAKTUAR]** me detyrë Nënkryetar i Bashkisë dhe me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2010, **gjobë në masën 50,000 lekë** pasi:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për vitin 2010:

-Nuk ka bërë deklaratë mbi konfliktin e interesit në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

-Ka proceduar në kundërshtim me urdhrin e prokurimit nr. 5, datë 01.4.2010 ku fondi nuk është ndarë në lote ndërkohë procedura është zhvilluar në bazë të ndarjes në 8 lote. Në bazë të raportit përmbledhës për procedurën e tenderit rubrika për operatorët që kanë kaluar fazën e vlerësimit paraqitet e paplotësuara. Në bazë të miratimit të raportit përmbledhës datë 17.5.2010 KVO ka shpallur fitues ofertuesin [REDAKTUAR] me drejtues ligjor zj. [REDAKTUAR] me vlerën 2,300,000 lekë pa TVSh. Tenderi gjatë procedurës së shpalljes në sistemin elektronik është ndarë në 8 lote, pa miratim të autoritetit kontraktor dhe pa akte ku është mbështetur për këtë ndarje në lote, e

konfirmuar kjo ne buletin e datës 12 Prill 2010 f. 89, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” të ndryshuar, Kreu III, pika 2, germa a. Nga 8 lote në shumën e fondit limit 2,416,666 lekë pa TVSh janë shpallur fitues operator të ndryshëm për 6 lote, për dy lote të tjera nuk është marrë asnjë vendim nga KVO. Në 4 lote ku është shpallur fituese [REDAKTUAR], nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se nuk administron licencën profesionale.

Këto shkelje janë vërejtur në tenderin “Hartim projektsh të infrastrukturës rrugore dhe arsimore në Bashkinë Peshkopi” me fond limit 2,416,666 lekë pa t.v.sh. zhvilluar më datë 22.4.2010.

b) Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, ligjit 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, për shkeljet e konstatuara në mbajtjen e kontabilitetit, mbështetur në nenin 72 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për Kontabilitetin”, kërkojmë të gjohet:

1. **Z.** [REDAKTUAR] me detyrë inspektor në dispozicion në cilësinë e ish Përgjegjësit të Sektorit të Financës, pasi:

- nuk ka përdorur sipas destinacionit të përcaktuar me ligj të ardhurat nga lejet e ndërtimit. Sipas detajimit nga 17,474,756 lekë në total për dy vitet vetëm 4,191,418 lekë ose 24 % është përdorur sipas destinacionit të përcaktuar në ligj pjesa tjetër është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera si paga e sigurime shoqërore si dhe nuk ka bërë në kontabilitet ndarjen e të ardhura për financimin e studimeve urbanistike dhe ato për financimin e infrastrukturës.

Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 5, ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për Kontabilitetin” si dhe ligjet për buxhetin dhe udhëzimet në zbatim të tij

#### **D. MASA DISIPLINORE**

I. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

#### **“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a**

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë Specialist në Zyrën e Pronave në cilësinë e mbajtjesit të protokollit të mbledhjeve të KRRT-së.

-Për shkelje të procedurave në mbajtjen e protokollit të mbledhjeve të KRRT-së ku nuk është reflektuar dokumentacioni i shqyrtuar dhe diskutimet përkatëse si dhe nuk janë mbyllur mbledhjet me numër rendor të sekretuar duke lënë hapësirë për shtesa të mëvonshme si në protokollin e datës 05.3.2010 me numër protokollit 15 ku është shtuar më vonë pika me numrin rendor 9 “[REDAKTUAR] pranë godinës respektive. Miratohet leja e dhënë nga Zyra e Urbanistikës e Bashkisë” e cila nuk është shqyrtuar nga KRRT-ja dhe nuk figuron në vendimin përkatës të kësaj mbledhje me nr. 15, datë 05.3.2010 në kundërshtim me nenin 20, 21 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar.

2. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor i Ndërtimit Urbanistik.

-Për moszbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar si dhe VKM nr. 862, date 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INU Kombëtar e ai vendor” pika 1 (iii) si dhe pika 2 dhe 3 pasi në praktikat e inspektimit nuk është mbajtur dokumentacioni i kërkuar si akt pezullimi , akt verifikimi etj. si dhe për mosveprim në ndërtime të përfunduara me leje ndërtimi të pazbardhura si rezultat i shmangies së likuidimit të detyrimeve ndaj Bashkisë si rezultat dhe i mungesës së bashkëpunimit me seksionin e urbanistikës.

3. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë, Inspektor i Administrimit, Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

- Për moszbatim të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit” aneksi I dhe II; të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “ Për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar, dhe rregullores së miratuar nga Këshilli Bashkiak nr. 35, datë 08.10.2007 neni 35; Urdhrin e Përbashkët nr. 1530, datë 07.04.2003 të Ministrin të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit me Ministrin e Rendit Publik pasi në Policinë Bashkiake janë rekrutuar punonjës pa arsimin përkatës dhe pa iu nënshtruar kualifikimeve përkatëse sipas kërkesave të legjislacionit të sipërcituar.

- Për mos zhvillim të konkurrimit, mos lidhjen e disa kontratave të punës dhe mos përcaktimin e masave disiplinore në kontratat individuale të punës.

**4. Për z. [REDAKTUAR]** me detyrë, Nënkyetar i Bashkisë në cilësinë e Përgjegjës të Taksave e Tarifave Vendore.

-Për mos evidentim dhe ndjekje të 44 subjekteve të biznesit që ushtrojnë aktivitetet pa leje duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Bashkisë në vlerën 1,136,667 lekë.

- Për mos planifikim real , mos ndjekje të procedurave ligjore për subjektet debitorë , mos ndjekje të subjekteve pa leje gjatë vitit 2010-2011.

Veprime këto në kundërshtim me ligjet dhe udhëzimet për zbatimin e buxhetit dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar si dhe ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**5. Për z. [REDAKTUAR]** me detyrë Polic i Bashkisë në cilësinë e ish Kryeinspektorit të Policisë Bashkiake në vitin 2010.

-Për moszbatim të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 49 pika 1 shkronja (a,b) si dhe neni 49/1 pika 2 dhe 3, pasi nuk ka ushtruar kontroll dhe nuk ka marrë masa për bllokimin, sekuestrimin dhe vendosjen e gjobave për subjekte që ushtrojnë veprimtari pa leje.

**6. Për z. [REDAKTUAR]** me detyrë Inspektor për Kadastrën Urbane në cilësinë e ish Përgjegjës të Sektorit të Pronave dhe Strehimit.

- Për mangësitë e shkeljet e konstatuara mbi administrimin e aseteve , procedurën e dhënies me qira dhe vlerësimit të aseteve në vartësi të Bashkisë.

-Për mos arkëtim të detyrimeve për objekte të marra me qira nga 68 subjekte në vlerën 4,957,390 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 24 “Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, në paragrafin e fundit.

**7. Për z. [REDAKTUAR]** specialist ne sektorin e taksave vendore.

- Për mos planifikim real , mos ndjekje te procedurave ligjore për subjektet debitorë , mos ndjekje te subjekteve pa leje gjate vitit 2010-2011.

Veprime këto në kundërshtim me ligjet dhe udhëzimet për zbatimin e buxhetit dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar si dhe ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**8. Për zj. [REDAKTUAR]** me detyrë specialiste e pagave.

-Për pagesa të kundërligjshme në shtesat mbi paga për vlerën 1,248,874 lekë dëm ekonomik, përkatësisht:

a. Për pagesën orë jashtë orarit punës, në kundërshtim me pikën 1/2, 3 dhe 3/a e b të Udhëzimit MF nr. 16, datë 20.07.2011, me pikën 1/ç të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 ”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

b. Për pagesën e lejeve të zakonshme të vitit 2010, gjatë vitit 2011, veprim në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 1/d ”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

c. Për shpërblime të ndryshme dhe aktivitete social kulturore, veprim në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimit të fondit veçantë”, me pikën 1/b të VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2010”, me pikën 1/c të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

d. Për mos mbajtjen e ditarit të pagave, veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe me VKM nr. 70, datë 11.03.1985.

**9. Për zj. ■■■ me detyrë inspektore e magazinës dhe inventarizimit.**

-Për mangësi në 4 raste me veprimet e magazinës, në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, VKM nr. 70, datë 11.3.1985 si dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për mos kontroll të magazinës për peshën nën standardet të artikullit bukë, në kundërshtim me kontratën datë 5.5.2011 dhe kontratës shtesë datë 16.01.2012 neni 7 dhe me nenin 13/ç të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

-Për vlerën 12,000 lekë dëm ekonomik karburant, sipas fletëdaljes nr. 113 datë 31.03.2010, çka bie ndesh me kontratën datë 25.02.2010.

-Për të meta e mangësi në inventarizimin e pasurisë dhe në nxjerrjet jashtë përdorimit. Për mos prerjen e fletëdaljeve për materialet e nxjerra jashtë përdorimit, duke i shkarkuar ato nga kontabiliteti ekstrakontabël për vlerën 9,160,341 lekë sipas formatit nr. 6 “Ndryshimet e AQ, zëri pakësimit” të bilancit 2011.

Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 10, 11 pika 4 e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” ndryshuar dhe me VKM nr. 70, datë 11.03.1985.

**“Pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në dy vjet”, neni 25, pika 3, germa c**

**1. Për z. ■■■ me detyrë Inspektor për Planifikimin e Zhvillimin e Territorit në cilësinë e ish Përgjegjësit të Seksionit të Urbanistikës.**

- Për moszbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 51 lidhur me përcaktimin dhe arkëtimin e taksës për financimin e studimeve urbanistike dhe të ndikimit në infrastrukturë nga të ardhurat nga lejet e ndërtimit duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Bashkisë në shumën 7,133,759 lekë.

- Për të meta e mangësi në procedurat për dhënie leje sheshi dhe leje ndërtimi në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar në mungesë të Planit të Përgjithshëm Rregullues, në dokumentacionin përkatës që duhet të plotësojnë subjektet për zbardhjen e lejes së ndërtimit dhe për administrim të dobët të Seksionit të Urbanistikës dhe mungesë praktikash të dhënieve të lejeve të ndërtimit si rezultat i mos protokollimit dhe mos arkivimit të dosjeve.

- Për dhënie leje ndërtimi pa u shqyrtuar në KRRT të Bashkisë.

- Për dhënie leje shesh ndërtimi pa studim urbanistik pjesor.

- Për mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi me INU të Bashkisë për ndërtime të përfunduara por me leje ndërtimi të pazbardhur si dhe me Seksionin e Financës për përcaktimin dhe ndarjen për arkëtim të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe për financimin e studimeve urbanistike.

-Për pa saktësi në listë prezencën e mbledhjeve të KRRT-së me pasojë dëm ekonomik në vlerën 32,400 lekë.



2. Për z. ■■■ me detyrë jurist.

-Për mos ndjekje të padive civile në të gjithë shkallët e gjyqësorit në dy raste ndaj subjekteve ■■■ dhe ■■■

-Për mos nxjerrje të përgjegjësisë ndaj personave përgjegjës të Bashkisë për dy vendime gjyqësore kundër vendimeve të Bashkisë për pushim nga në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 1, datë 21.01.2010 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010" pika 44.

3. Për z. ■■■ në dispozicion, në cilësinë e ish Përgjegjës të Sektorit të Financës.

-Për mos miratimin në Këshillin Bashkiak të normativave celulare dhe karburantit.

-Për mos planifikim në buxhetin e vitit 2011, të vlerës faturave të pa likuiduara të prapambetura të llogarisë 602, çka bie ndesh me pikën 1.2 të Udhëzimit nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011".

-Për pagesën (ndihmë shëndetësore, dëmtim banese dhe fatkeqësi) e dhënë nga fondi rezervë 72 qytetarëve për vlerën 1,700,000 lekë dëm ekonomik me pamundësi kthimi, pasi ky shpenzim nuk ka mbështetje ligjore dhe nuk ka dokumente justifikuese, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1151, datë 25.11.2009, udhëzimit nr. 50, datë 09.12.2009 "Mbi Fondin e Veçantë" pika 7/2, me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011" pika 3.8, fondi rezervë pika 65 dhe pika 4.2 "të tjera" nënpika 100 fondi rezervë, sipas mandatpagesës nr. 24, datë 18.4.2011, urdhër shpenzimit nr. 96, datë 5.4.2011 dhe VKB nr. 15, datë 5.4.2011 dhe nr. 7, datë 01.03.2011.

-Për pagesa dieta të tepërta në vlerën 143,300 lekë dëm ekonomik, veprim në kundërshtim me VKM nr. 228 datë 13.04.2001 "Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre", me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit" pika III/3 nënpika 3.2 dhe pika III/3 nënpika 3.3 si dhe me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 "Për tarifatat e transportit udhëtarëve".

-Për mos marrjen e masave ndaj punonjësve vartës, për mos mbajtjen e ditarit pagave, veprimeve ndryshme dhe për kalimet e veprimeve ekstrakontabël në bilanc.

II. Mbështetur në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës" me ndryshimet e mëvonshme kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

### "Zgjidhje të kontratës së punës"

1. Për z. ■■■ me detyrë Specialist në Sektorin e Shërbimeve në cilësinë e ish-magazinierit.

-Për pranimin dhe magazinimin e artikullit bukë nën peshën standarde, pasi ka bërë hyrje bukë për periudhën prill-dhjetor 2011 për 0.2 kg/copë diferencë mangët, buka është 0,8 kg nga 1 kg që duhej. Ndaj firmës së bukës nuk ka kundërshtuar për diferencat 0,2 kg për çdo bukë, çka bie ndesh me nenin 11 të kontratës 5.5.2011. Veprim në kundërshtim me kontratën datë 5.5.2011 dhe kontratës shtesë datë 16.01.2012 neni 7 ku thuhet "Buka duhet të jetë në peshë 1 kg dhe çmimi i bukës të jetë për 1 kg" dhe me nenin 13/ç të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar e kontrollin".

-Për vlerën 12,000 lekë dëm ekonomik karburant, sipas fletëdaljes nr. 113, datë 31.03.2010, çka bie ndesh me kontratën datë 25.02.2010.

-Për fiktivitet në fletëhyrjen nr. 28, datë 21.3.2009 artikulli gazoil, pasi është bërë hyrje 10 ditë para prerjes faturës subjektit nr. 332, datë 01.4.2009 seria 42054181.

-Për prerje të disa fletëdaljeve pa urdhër dalje të eprorit.

-Për të meta e mangësi në hartimin e fletëdaljeve dhe fletëhyrjeve, pasi nuk plotësohen sipas kërkesave, kanë korrigjime e mangësi në plotësimin e tyre dhe mungesë të dhënash.

-Për furnizim dhe prerje të disa fletëdaljeve të karburantit pa fletudhëtimet përkatëse, për mjetet e baskisë, furgonin dhe Wolzwagenin.

-Për mos bërje hyrje të planit rievimit banesave sociale për vlerën 63,700 lekë si dhe materiale inerte gurë dhe zhavorr sipas faturës nr. 3, datë 20.7.2011 për vlerën 294,000 lekë, veprim në

kundërshtim me kërkesat e nenit 13/c të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për prerje fletëdaljeve për dru zjarri dhe gaz i lëngshëm pa grafik shpërndarje sipas sektorëve dhe zyrave, mbi bazën e një normative të caktuar dhe të miratuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, Besim Bileri dhe Hysen Metko. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**